

Depistimi i kancerit të gjirit

Informacion
mbi programin e depistimit
në Gjenevë



depistage-ge.ch/documentation

Kanceri i gjirit në shifra

Kanceri i gjirit është kanceri më i shpeshtë te gratë.

Çdo vit në Zvicër rreth 6'600 gra kanë një kancer gjiri dhe 1'400 vdesin prej tij.

Një kancer i shpeshtë



**1 grua nga 8 do të ketë një
kancer të gjirit gjatë jetës së saj**


Burimi : Organe national d'enregistrement du cancer
(Organi Kombëtar i Regjistrimit të Kancerit) (ONEC – 2017-2021)

89% e grave jetojnë ende 5 vjet pas diagnozës.

Burimi : liguecancer.ch (2025)

Burrat mund të zhvillojnë gjithashtu një kancer të gjirit, por kjo është e rrallë. Në Zvicër, rreth 60 burra kanë kancer të gjirit çdo vit dhe 10 vdesin prej tij.

Risku rritet me moshën



- Kancerat e gjirit zbuluar para 50 vjeç /
- Kancerat e gjirit zbuluar duke nisur nga 50 vjeç /

Burimi : ONEC — 2017-2021

Çfarë është depistimi i kancerit të gjirit?

- Depistimi synon të zbulojë kancerin e gjirit në një fazë më të hershme, para shfaqjes së simptomave, kur është më e thjeshtë për t'a kuruar.
- Depistimi bëhet me mamografi.** Bëhet fjalë për një radiografi të gjinjve. Ai rekomandohet **çdo dy vjet për gratë 50 vjeç e lart.**

Avantazhet, disavantazhet dhe kufizimet e depistimit


Si të gjithë ekzaminimet mjekësore, mamografia e depistimit ka avantazhet dhe të metat e veta. Pjesëmarrja në programin e depistimit është një zgjedhje personale. Është e rëndësishme të informoheni për të marrë një vendim.

Avantazhet

- Mamografia lejon përgjithësisht zbulimin e hershëm të kancerit. Kjo rrit shpesh **mundësitë për shërim** dhe kontribuon në zvogëlimin e rrezikut të vdekjes nga një kancer i gjirit
- **Trajtimi mund të jetë më pak i rëndë** nëse kanceri zbulohet herët.
- Në kuadrin e programit të depistimit:
 - zbatohen **norma strike të cilësisë**, veçanërisht leximi i mamografive prej dy ose tre radiologë, gjë që lejon përmirësimin e besueshmërisë së diagnozës;
 - **shpenzimet mbulohen në masën 90%** nga sigurimi bazë shëndetësor. Nuk ka franshizë për t'u paguar.
 - analiza e të dhënave të mbledhura **përmirëson njohuritë mbi efikasitetin** e depistimit.

Disavantazhet

- Ekzaminimi mund të jetë i **parehatshëm**. Gjiri shtypet midis dy pllakave gjatë disa sekondave për të marrë një imazh të mirë dhe reduktuar ekspozimin ndaj rrezeve.
- Bërja e ekzaminimeve dhe pritja e rezultateve mund të sjellë **shqetësimin**.
- Bërja e ekzaminimeve dhe pritja e rezultateve mund të sjellë shqetësimin.
- Një **fals-pozitiv** do të thotë që mamografia tregon një anomali, por ekzaminimet shtesë tregojnë në vijim se nuk është një kancer. Bëhet fjalë për një alarm fals.
- **Risku i mbitrajtimit**: gjatë diagnozës së një kanceri, është e vështirë të parashikohet me siguri si do të zhvillohet. Disa tumore që zhvillohen shumë ngadalë trajtohen me kujdes ndërkohë që nuk do të ndikonin kurrë në shëndet.



Kufizimet

- Disa kancere janë të padukshme në imazhe ose zhvillohen midis dy ekzaminimeve. Në disa raste, një kancer mund të mos zbulohet në këtë mënyrë gjatë një mamografie. Prandaj është e rëndësishme që ekzaminimi të përsëritet çdo dy vjet.
- Mamografia e depistimit nuk parandalon shfaqjen e një kanceri gjiri.
- Depistimi lejon shpesh të zbulohet herët një kancer, por disa kancere janë të vështirë për t'u kuruar.

Depistimi: për kë dhe kur ?

A paraqisni një nga këto simptoma në njërën gji ?

	Po	Jo
Një gungë	☐	☐
Një dhimbje e vazhdueshme	☐	☐
Një rrjedhje nga thithka	☐	☐
Një ndryshim i lëkurës ose i formës së gjirit	☐	☐

A keni ndonjë histori personale ose familjare mjekësore?

	Po	Jo
Histori personale e kancerit të gjirit	☐	☐
Një histori familjare të kancerit të gjirit (prindër, vëlla, motër, fëmijë)	☐	☐
Një patologji e gjirit që ka nevojë për ndjekje	☐	☐
Një risk gjenetik i rritur i kancerit të gjirit (p.sh. : BRCA)	☐	☐

Ju jeni përgjigjur JO ndaj të gjitha pyetjeve ?


✓ Mund të bëni një depistim në kuadrin e programit nëse :

- Jeni një **grua 50 vjeç e lart**;
DHE
- Banoni **në Gjenevë**, cilado qoftë shtetësia ose leja juaj e qëndrimit; OSE jeni kufitar që punon ose ka punuar **në Gjenevë** dhe **e siguruar pranë LAMal**.

A i jeni përgjigjur PO një ose disa pyetjeve?

? Konsultoni mjekun tuaj për të ditur nëse depistimi i adaptohet situatës suaj.

Si zhvillohet depistimi im në program ?




* Pas moshës 74 vjeç, nuk marr më ftesë, por mund ta kërkoj një të tillë duke kontaktuar programin.

** Nëse nuk dua që një burrë të bëjë mamografinë time, e them këtë gjatë caktimit të takimit.

*** Në disa raste, një ekzaminim shtesë është i nevojshëm, sepse imazhet janë të vështira për t'u interpretuar. Kjo mund të jetë rasti nëse keni gjinjtë të dendur ose proteza.

Cilat janë rezultatet e depistimit në Zvicër ?




**Midis dy depistimeve, qëndrojt e vëmendshme ndaj gjinjve të mi.
Konsultoj mjekun tim nëse vë re një ndryshim të pazakontë .**

Shifra të rrumbullakosura. Shifra ekzakte të disponueshme në raport : Braendle K, Zwahlen M, Bulliard J-L. Breast cancer screening programs in Switzerland (Programme depistime të kancerit të gjirit), 2019-2021. Lausanne (Lozanë), Unisanté – Centre universitaire de médecine générale et santé publique (Qendër universitare e mjekësisë së përgjithshme dhe shëndetit publik), 2024 [Raisons de santé 356].

Sa më kushton një depistim në program ?

Sigurimi bazë shëndetësor (LAMal) mbulon 90% të kostos totale të mamografisë kur ajo kryhet në kuadër të programit të depistimit.



Sigurimi më dërgon një faturë për 10% e mbetur (më pak se 20 CHF). Kostoja e saktë ndodhet në letërën e ftesës dhe në faqen depistage-ge.ch.

Nuk ka pjesëmarrje fikse për t'u paguar.

Ekzaminime shpesh

Nëse ekzaminimet shpesh janë të nevojshme, ato kryhen jashtë programit të depistimit. Kostot merren në ngarkim sipas kushteve të zakonshme të kontratës suaj.

Ndihma financiare

- Përfituesit e një subvencionit të sigurimit ndaj sëmundjeve mund të kërkojnë një rimbursim prej 10%. Për këtë, dërgoni një kopje të vërtetimit të subvencionit të vitit aktual, si dhe të dhënat tuaja bankare në secretariat@fgdc.ch.
- Vështirësitë financiare nuk duhet t'ju bëjnë të hiqni dorë nga depistimi. Nëse jeni në këtë rast, telefononi në numrin 022 320 28 28.

Më shumë informacion



depistage-ge.ch

Për të lehtësuar leximin, kjo broshurë përdor termin 'grua' pavarësisht identitetit të gjinisë.

Më shumë informacion pranë :

Programme cantonal de dépistage du cancer du sein - Genève

depistage-ge.ch - 022 320 28 28

Mjekut tuaj

Swiss Cancer Screening

swisscancerscreening.ch

Ligue genevoise contre le cancer

lgc.ch

Ligue suisse contre le cancer

liguecancer.ch



**Dépistage du cancer
du sein Genève**

Fondation genevoise pour le dépistage du cancer (FGDC)

Boulevard de la Cluse 43

1205 Genève

022 320 28 28

secretariat@fgdc.ch

depistage-ge.ch

Avec le soutien de la République et canton de Genève